



# Aldo Kume

Drejtor

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Z. Aldo Kume është diplomuar në vitin 2010 pranë Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit, dega Hidroteknikë dhe në vitin 2012 është diplomuar për Master Shkencor në Hidroteknikë. Në periudhën 2010–2015, z. Kume ka punuar në sektorin privat me projekte të ndryshme Infrastrukturore, Civile dhe Energjie në projektim, zbatim e mbikëqyrje. Në funksion të ushtrimit të profesionit disponon Licensat profesionale të Projektimit dhe të Vlerësuesit të Pasurive të Paluajtshme.

Z. Kume ka filluar punë si auditues në KLSH më 01.06.2015, ku ka mbajtur pozicione të ndryshme duke filluar si Auditues i Dytë, Auditues i Parë, Auditues i Lartë dhe nga viti 2024 ka ushtruar detyrën e Kryeaudituesit në Departamentin e Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja.

Gjatë karrierës së tij profesionale në KLSH, ka marrë pjesë në disa konferenca, seminare dhe workshop-e të organizuara nga institucionet homologe ndërkombëtare, konkretisht në Turqi, Luxemburg, Slloveni, Poloni, Belgjikë, Norvegji etj.


Nga viti 2020, z. Kume përfaqëson KLSH-në, në takimet e Bordit Ndërkombëtar të Audituesve për NATO-n (IBAN), i cili është organi përgjegjës për auditimet e pasqyrave financiare dhe të performancës, për të gjitha subjektet raportuese të NATO-s, si dhe shpenzimet e Programit të Sigurisë dhe Investimeve të NATO-s.


Nga Mars 2025, z. Kume mban detyrën e Drejtorit të Departamentit të Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja.


Z. Kume është njohës i gjuhës angleze.



## Kontakt

 [akume@klsh.org.al](mailto:akume@klsh.org.al)

 Rruga "Abdi Toptani", Tiranë,  
Shqipëri

 [www.klsh.org.al](http://www.klsh.org.al)